



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KI.nr.1/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Divizioni për Investitor të Huaj, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike të paditësit “Planete Lots”, me adresë në 72 Route de Larlandaz në Albertville, Francë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “V...”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit “A3B” SH.P.K., me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës” nr.86, me NUI: 810155243, me objekt kontesti borxh, vlera e kontestit 45,268.92 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 08.06.2023, në prani të autorizuarit të paditësit, me datë 22.06.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Planete Lots”, dhe DETYROHET i padituri “A3B” SH.P.K., që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material të ia paguaj shumën prej 45,268.92 € (dyzet e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë euro e nëntëdhjetë e dy cent), me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë 31.03.2022 e deri në pagesën e plotë, në afat prej 7 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- I. DETYROHET i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 3,116.00 € (tre mijë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë euro), në afat prej 7 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi “Planete Lots”, me seli në Francë, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datë 31.03.2022, ka paraqitur padi ndaj të paditurit “A3B” SH.P.K., për pagesën e dëmit në emër të kompensimit të dëmit material në vlerë prej 45,268.92 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit,

nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm apo në mënyrë alternative i ka propozuar gjykatës që të detyrohet i padituri që paditësi t'ia kthen mallin sipas faturës nr.2021.11.19.00006 e lëshuar nga Planete Lots për A3B SH.P.K., dhe t'ia kthen shumën prej 7,330.29 € me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë, në afat prej 7 ditësh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. I autorizuari i paditësit në seancën përgatitore të datës 15.02.2023, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë ashtu që ka kërkuar që të detyrohet i padituri që të kompensoj dëmit material në vlerë prej 45,268.92 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Përfaqësuesi i paditësit në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me datë 20.11.2021 paditësi dhe i padituri kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, ku si rezultat i kësaj marrëveshje, paditësi e sjellë mallin në Kosovë, ndërsa i padituri të bëj shitjen e mallit. Tutje ka shtuar se, i padituri ka dështuar që të bëj shitjen e mallrave, ndërsa paditësi i ka propozuar që të kthen mallin apo të kryen pagesën e faturës në shumën prej 27,752.30 €, por i padituri ka kushtëzuar që për ta kthyer mallin, fillimisht duhet ti bëhet pagesa në shumën prej 27,752.30 € dhe për këtë lëshon edhe faturën Nr.004/2022 të datës 24.01.2022. Duke marrë parasysh dështimin në përmbushjen e obligimeve nga marrëveshja tregtare, paditësi me datë 05.02.2022, ka njoftuar të paditurin për shpërndarje të marrëveshjes dhe të njëjtit i ka kërkuar që të kthen mallin dhe të kthej paradhënien në shumën prej 12,000 €. Në fund, gjykatës i ka propozuar që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Gjykata lidhur me këtë çështje juridike, të paditurit “A3B” SH.P.K., me datën 21.12.2022, ka tentuar t'ia dorëzojë ftesën për seancën përgatitore të datës 11.01.2023, në selinë e tij në rrugën “Lidhja e Pejës” nr.86, Prishtinë, ndërsa nga fletëkthesa është konstatuar se pala është e panjohur në këtë adresë.

Gjykata duke vepruar në bazë të nenit 114 të LPK-së, i cili përcakton se *“Në qoftë se dorëzimi i shkresës subjektit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t'i bëhet në adresën e treguar në regjistër, komunikimi bëhet duke u ngjitur shkresa në tabelën e shpalljeve të gjykatës,*

*dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës.”, përmes aktvendimit KE.nr.1/22 të datës 11.01.2023, ka vendosur që dorëzimi i të gjitha shkresave dhe parashtresave ndaj të paditurit “A3B” SH.P.K., të bëhet me publikimin e tyre në tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate, për faktin se komunikimi me të paditurin ka qenë i pamundur në adresën e treguar në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë.*

Gjykata ka mbajtur seancën përgatitore me datën 15.02.2023 dhe seancën e shqyrtimit kryesor me datën 23.03.2023 dhe 08.06.2023, në të cilat seanca ka marr pjesë vetëm përfaqësuesi i paditësit, ndërsa nuk ka qenë prezent i padituri edhe pse i njëjti ka qenë i ftuar përmes tabelës së shpalljeve të gjykatës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor publik të datës 08.06.2023, ka bërë administrimin e të gjitha provave të propozuara nga pala paditëse dhe atë: Marrëveshja e bashkëpunimit e datës 20.11.2022; Fatura nr.2021.11.19.00006 së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe; Fatura nr.20325577 e datës 03.04.2022 së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe; Fatura nr.20325580 e datës 03.04.2022 së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe; Fatura nr.20325579 e datës 03.04.2023 së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe; Fatura nr.004/2022 e datës 24.01.2022 së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe; Njoftimi për shkëputjen e marrëveshjes tregtare e datës 15.11.2021 dhe Kërkesa për pagimin e obligimeve financiare ose kthimin e mallit e datës 25.02.2022; Komunikimet elektronike përmes e-mail ndërmjet përfaqësuesit të paditësit dhe të paditurit e datës 26.01.2022 dhe e-mail i datës 25.01.2022; Paradhënia për tarifatat doganore e datës 26.11.2021; Ekspertiza financiare e punuar nga eksperti Ramadan Ferizi e datës 07.04.2023.

Deklarimet e përfaqësuesit të paditësit, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se:

Nga Marrëveshja e bashkëpunimit e datës 20.11.2022, konstatohet se paditësi “Planete Lots” dhe i padituri “A3B” SH.P.K., me datën 20.11.2021 kanë arritur marrëveshje bashkëpunimi

me numër 0201121, për tregtimin e mallrave të ndryshme nga Bashkimi Evropian, ku i padituri do të përfaqësoj paditësin për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Nga Fatura nr.2021.11.19.00006 së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe, konstatohet se me datën 19.11.2021 paditësi ka lëshuar faturën me 36 paleta kozmetikë, në shumën prej 28,914.80 €.

Nga Faturat nr.20325577, nr.20325580, nr.20325579, konstatohet shuma e transportit të mallrave në vlerë prej 5,516.62 €.

Nga Fatura nr.004/2022 e datës 24.01.2022 së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe, konstatohet se e njëjta është lëshuar nga i padituri “A3B” SH.P.K., në shumë prej 27,026.77 € dhe se nuk është e nënshkruar nga palët ndërgjyqëse.

Nga Njoftimi për shkëputjen e marrëveshjes tregtare e datës 15.11.2021 dhe Kërkesa për pagimin e obligimeve financiare ose kthimin e mallit e datës 25.02.2022, rezulton se paditësi ka njoftuar të paditurin për shkëputjen e marrëveshjes tregtare të datës 20.11.2021 me efekt prej 7 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit.

Nga Komunikimet elektronike përmes e-mail ndërmjet përfaqësuesit të paditësit dhe të paditurit e datës 26.01.2022 dhe e-mail i datës 25.01.2022, konstatohet se i padituri i është drejtuar me email paditësit, duke e njoftuar se mallin mund ta merr pasi të paguhet fatura dhe shuma e mbetur në vlerë prej 7,330.29 €, do të mbet si garanci deri në përfundimit e procedurës gjyqësore. Tutje, konstatohet se i padituri e ka njoftuar paditësin për moshitjen e mallrave, ndërsa paditësi ka ofruar një strategji për shitje e cila do të mund të zbatohet.

Nga Paradhënia për tarifatat doganore e datës 26.11.2021, konstatohet se drejtori i kompanisë “A3B” SH.P.K., deklaroi se ka marrë shumën prej 12,000 €, nga z. Philippe Marclay, për zhdoganimin e mallrave në Kosovë, ndërsa pjesa e mbetur duhet ti kthehet të njëjtit, pasi të jenë kryer të gjitha formalitetet dhe shpenzimet e zhdoganimit. Deklarata e të paditurit është e vulosur dhe e nënshkruar.

Nga Ekspertiza financiare e punuar nga eksperti Ramadan Ferizi e datës 07.04.2023, konstatohet se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, mendimi i ekspertit është se i paditur “A3B” SH.P.K., i ka borxh paditësit “Planete Lots”, shumën prej 45,268.92 €

Në kontekstin e përgjithshëm të procedurës provuese, duke vlerësuar pretendimet e paditësit, respektivisht të autorizuarit të tij, lidhur me bazueshmërinë e kërkesëpadisë, gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar andaj të njëjtën e ka aprovuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Këtë qëndrim gjykata e ka marrë duke iu referuar nenit 7 dhe 245 të LMD-së të cilët parashohin se te kontratat me shpërblim pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke dhe se kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij, e në qoftë se debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar, andaj gjykata bazuar në këto dispozita dhe në gjendjen faktike të konstatuar, ka vlerësuar se me lidhjen e marrëveshjes për bashkëpunim, palët me vullnetin e tyre kanë marrë për obligim përmbushjen e obligimeve sipas kësaj marrëveshje, përkatësisht i padituri ka marrë për obligim pagesën e çmimit të mallrave të pranuar. Po ashtu gjykata vlerëson se marrëveshja për bashkëpunim, ka efekt juridik pasi që e njëjta është e nënshkruar dhe vulosur nga të dy palët kontraktuale.

I padituri, duke mos e kryer detyrimin e tij, rezulton se i ka mbetur borxh paditësit për pagesën e mallit në shumën prej 45,268.92 €, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa i padituri cilësinë e debitorit. Prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se i padituri me mospagimin e detyrimit sipas marrëveshjes për bashkëpunim, i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurin që paditësit t’ia paguaj borxhin në shumën e gjykuar.

Këtë bindje gjykata e krijoji duke u nisur nga fakti se paditësi dhe i padituri kanë lidhur ndërmjet tyre marrëveshje më të cilën është përcaktuar qartë detyrimi i palës së paditur, andaj sipas qëndrimit të kësaj gjykate marrëveshja të cilën palët e lidhin mbi çështjen kontestuese, pa marrë parasysh nëse është bërë gjatë procedurës para gjykatës (pajtimi gjyqësor) ose jashtë gjykatës (pajtimi jashtë gjyqësor), paraqet në fakt kontratë të palëve, me të cilën ato i rregullojnë raportet e tyre civilo-juridike. Kjo për faktin se në aspektin e të së drejtës procedurale, marrëveshja është akt i disponibilitetit të palëve me të cilën ato i rregullojnë të drejtat dhe obligimet e ndërsjella, ndërsa në kuptim të së drejtës materiale marrëveshja e lidhur ndërmjet palëve ka cilësinë e kontratës sepse i përmban të gjitha elementet e kontratës. Në rastin konkret, nga provat e administruara, rezulton i pa kontestueshëm fakti se palët kanë lidhë marrëveshje bashkëpunimi dhe përfaqësimi të kompanisë nga Zvicra për tregtimin e mallrave të ndryshme nga Bashkimi Evropian ku kompania vendore A3B SH.P.K., do të përfaqësoj kompaninë Planete Lots për rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe pagesat të bëhen sipas marrëveshjes, ndërsa për mallrat e dhëna konsumatorëve pagesa të bëhet në avans ose përmes garancionit bankar.

Vendimin në lidhje me lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e ka bazuar në raportin e ekspertizës financiare, të punuar në këtë çështje juridike nga eksperti financiar Ramadan Ferizi, sipas të cilit paditësi ka dërguar mallin sipas faturës Nr.2021.11.19.00006 datë 19.11.2021, vlera e së cilës është në shumën prej 27,752.30, pas zbritjes së shumës prej 1,162.50 € nga vlera totale e faturës prej 28,914.80 €, për shkak të mos dërgimit të 1,150 parfumeve, faturat e transportit në shumën prej 5,516.62 €, si dhe shumën prej 12,000.00 €, për kryerjen e procedurave doganore, pas llogaritjes të së cilave ka konstatuar se i padituri i ka mbetur borxh paditësit në shumën e përgjithshme prej 45,268.92 €. Rrjedhimisht duke u bazuar në shkresat e lëndës gjykata ka ardhur në përfundim se shuma e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është shuma të cilën i padituri duhet t'ia paguaj paditësit.

Meqenëse i padituri, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së, e ka detyruar të paditurin që t'ia paguaj paditësit, shumat e gjykuara së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%, nga data e parashtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, dhe palës paditëse në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore i janë miratuar shumat si në vijim: në emër të përpilimit të padisë shuma prej 416.00 €, në emër të taksave gjyqësore shumë prej 120.00 €, për shpenzimet e ekspertizës shuma prej 150.00 €, për përfaqësim në 5 seanca gjyqësore shuma prej 2,430.00 €, në shumën e përgjithshme prej 3,116.00 €.

Nga arsyet e cekura më lart, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KI.nr.1/22, datë 22.06.2023

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.